

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA PRRENJAS

RAPORT TEKNIK I PROJEKT-ZBATIMIT



OBJEKTI:
PUNIME NDËRTIMI PËR SHITESË AMBJENTESH NË SHKOLLËN E
MESME DILAVER NEZHA QUKËS SHKUMBIN
-BASHKIA PRRENJAS-

KONSULENT
“ZETAKONSULT” SHPK & “ZENIT&CO” SHPK

Two handwritten signatures in blue ink, one on the left and one on the right, positioned over a faint circular stamp. The stamp contains text in Albanian, including "ZETAKONSULT" and "ZENIT&CO".

Permbajtja:

1. Të dhënat e Projektit
2. Kondicionet Urbane
3. Gjëndja Ekzistuese e sheshit të Ndertimit
4. Foto të gjëndjes ekzistuese:
5. Studimi Pjesor Urbanistik
6. Koncepti dhe Zgjidhja Arkitektonike.
7. Organizimi dhe Zgjidhja Funksionale e Ambienteve
8. Programi i Realizuar i Hapesirave
9. Qarkullimi - Akseset hyrese / Dalese
10. Zgjidhja konstruktive.
11. Materialet Ndertimore te Aplikuara
12. Sistemet dhe Kushtet Teknike te Ambjenteve
13. Pamje te Renderuara



1. TË DHËNAT E PROJEKTIT:

Investitori I Projektit: **Bashkia Prrenjas**

Projekti I Këkuar: **Studim-Projektim**

Emertimi I Objektit: **Punime ndërtimi për shtese ambjentesh në shkollën e mesme "Dilaver Nezha"-Qukes Shkumbin", Nj/A Qukes, Bashkia Prrenjas.**

Nr. Nxenesve në shkollën ekzistuese 2 kate: **250 nxenes**

Nr. Nxenesve që do të zhvillojnë mesim në shtesën e re: **+60 nxenes**

Vendndodhja: **Rruga e Xhamisë fshati Qukes-Shkumbin, Prrenjas.**

Te dhënat e Paurisë:

Nr i Pasurisë: **192**

Zona Kadastrale: **192**

Sipërfaqja e Parceles sipas matjeve Faktike: **4661.3 m²**

2. KONDICIONET URBANE:

Koeficienti i Shfrytëzimit të Territorit Lejuar : 50 %

Njësia strukturore: **2/6**

Kategoria: **Arsim**

Lartësia në kate e lejuar: **2 kate**

Sipërfaqja e zënë nga struktura ekzistuese: **351.8 m²**

Sipërfaqja e gjurmës e zënë nga struktura shtesë: **333.4 m²**

Sipërfaqja e ndërtimit godina ekzistuese: **703.6 m²**

Sipërfaqja e ndërtimit godina Shtesë: **666.2 m²**

Sipërfaqja ndërtimi Totale: **1369.8 m²**

Kosto e Preventivuar:

.....




3. GJËNDJA EKZISTUESE E SHESHIT TË NDERTIMIT

Përshkrim: Parcela në të cilën ndodhet shkolla "Dilaver Nezha" ka një sipërfaqe prej **4661.3 m²**. Në këtë parcelë ndodhen dy godina dy kateshe ku njëra është në funksion e cila ka një kapacitet prej 250 nxënës dhe tjetra është jashtë funksionit si pasojë e dëmeve strukturore.

Territori i shkollës përbëhet edhe nga hapësirat e rekreacionit të cilat pozicionohen në anën jugore -perendimore, përballë shkollës. Hapësira e vënë në dispozicion ndodhet në anën veriore të parcelës.

Vendodhja sipas Hartes Asig:



4. FOTO TË GJËNDJES EKZISTUESE:

Hapesira ku propozohet te ndertohet shtesa anesore:





[Handwritten signature]



Handwritten signatures in blue ink, possibly indicating approval or ownership.



[Handwritten signature]



[Handwritten signature]



[Handwritten signature]

5. STUDIMI PJESOR URBANISTIK

Gjate hartimit të Studim-projektimi janë marre parasysh kondicionet urbane sipas studimi urbanistik i miratuar të zones 2/6 ne te cilin jepet informacion mbi kondiconet dhe destinacionin e zones. Parcela e shkolles eshte e pozicionur dhe kufizohet nga te tre anet nga parcela private dhe ne anen jugore me rruge lagje. Koeficienti I Shfrytëzimit te Territorit eshte $i=50\%$



6. KONCEPTI DHE ZGJIDHJA ARKITEKTONIKE E GODINES SHITES.

Duke pasur parasysh kondicionet urbane dhe formen e parceles e cila eshte vene ne dispozicion nga bashkia e Prrënjës është propozuar nje zgjidhje sa me e pershtatshme duke respektuar te gjitha norma e projektimit per objektet arsimore. Gjurma e godiens se shtuar eshte 333.4 m^2 dhe do te ngrihet ne lartesine e dy kateve me Çati. Siperfaqja Totale e ndertimit të godines se re do te jete rreth 666.8 m^2 .

Gjate procesit te projektimi është marre ne konsiderate godina ekzistuese e cila do te luaje nje rol të rendesishem për konceptin dhe zgjidhjen arkitektonike me te favorshme.

Godina e re e propozuar do te integrohet me godinen ekzistuese duke e bashkengjitur dhe lidhur me korridore. Godinat do te kene nje holl te perbashket dhe do te aksesohen nepermjet korridoreve lineare. Aksesit ne vertikalitë do realizohet me ane te shkalleve te dedikuara per godinen ne teresi.

Parashikohet të behet akomodimi i klasave si pjese e zgjatimit te shkolles por edhe e kopeshtit i cili parashikohet të vendoset në të njejten godine por me hyrje te dedikuar nga ana perendimore.

Pozicionimi i klasave do te behet nga jugu-perendimor dhe lindja per te ofruar ndicim sa me te mire, ndersa ne anen veriore do vendosen ambientet sekondare dhe terciare.

Ambientet e kopshtit do të vendosen ne katin përdhe për te ofruar nje akses sa me komod per fëmijet dhe hyrja do te behet nga ana perendimore nga ku jane vendosur dhe ambientet e rekreacionit. Aksesit do te jete i ndare nga shkolla.

Volumetria:

Godina e re do te kete forme drejkendore ne plan dhe zhvillohet si zgjatim i godines ekzistues. Godina do te zhvilloj nje volumetri kuboidale te rregullt ne aksonometri.

Fasadat:


Godina do te kete hapje masive ne pjesen e hollin per te lejuar driten dhe ventilim natyral sa me te mire.

Eshte aplikuar perdorimi i dritareve te gjera ne klasa per marre sa me shume drit dhe ventilim natyral.

Ne fasada do te perdoren ngjyra neutrale ne nje raport 70/30.

RAL 8012 30 %

RAL 9016 70 %



7. ZGJIDHJA FUNKSIONALE E AMBJENTEVE

Pershkrimi i Ambjenteve në Shkollën Ekzistuese:

KATI ± 0.00 KOPSHTI / LABORATORE / HOLL / NHS

Ne katin ± 0.00 do të jenë të vendosura 2 laboratore me nga 24 nxenes. Kopshti do të organizohet në dy grupe. Pjesë integrale e kopshtit do të jetë dhe një mini-kuzhine banak me qëllim përgatitjen e ushqimit të shpejtë. Gjithashtu ambjettet e grupeve janë të lidhura me nyjet sanitare të drejtperdrejta. Zona e kopshtit do të ketë dhe një derë lidhëse me pjesën e shkollës e cila u shërben stafit për të komunikuar me pjesën tjetër të shkollës por edhe në rast emergjence. Nukli i tualetëve të nxenesve dhe stafit do të vendoset në pjesën veriore.

KATI 1 HOLL / KLASA / ADMINISTRATA / ZYRA / INFERMIERI / NHS

Ne katin +1 do të jenë të vendosura 2 klasa normale me 24 nx dhe një klasë burimore. Në këtë kat do të jetë edhe zyrat e drejtoreve. Nukli tualetëve ndodhet në pjesën veriore. Për arsye të kontrollit sa më të mirë obnorrës kryesore dhe korridoreve është bërë e mundur vendosja e sallës së mesuesve në qendër. Salla e mesuesve është zgjeruar dhe mbetet në pozicionin origjinal. Në kat do të ketë zyrat e administratës së shkollës si ato të nën-drejtoreve.

Godina Shtesë 2 kate:

Në hartimin e projektit janë marrë parasysh këto kritere:

- Ndarja e ambienteve sipas grup moshave:

Në këtë shkollë është specifike që nxenesit të ndahen për shkak të moshës, zhvillim të ndryshëm fizik e mendor. Prandaj është e këshillueshme që të bëhet një grupimi sipas moshave. Për këtë arsye në zgjidhjen e projektit është konceptuar që në volumn 2 kate shtesë ambientet e kopshtit të vendoset të ndara dhe me hyrje të dedikuara.

- Orientimi i ambienteve mesimor


Për të pasur një orientim sa më të mirë është përdorur skema me klasa në një anë të koridorit. Klasat e mesimit janë orientuar nga lindja dhe jugu dhe koridoret janë vendosur në qendër.



[Handwritten signature]
15



Handwritten signature in blue ink, possibly reading "A. K. Dhu".



KONSULENT
“ZETAKONSULT” SHPK & “ZENIT&CO” SHPK
Perfaqesues
Ing.Lorenc Hoxha

Ark. Raimonda MYDILLARI



Raimonda
a

Digitally signed by
Raimonda Mydillari
Date: 2024.09.27
10:05:19 +02'00'

Lorenc
Hoxha

Digitally signed by
Lorenc Hoxha
Date: 2024.09.27
10:09:51 +02'00'